

Tiranë, 02.07.2026

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit

Lënda: Komente nga FIAA mbi Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026-2030 dhe të planit të saj të veprimit”.

Në vijim të procesit të konsultimit publik mbi draftin e **Projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026-2030 dhe të planit të saj të veprimit”**, dëshirojmë të ndajmë disa komente dhe rekomandime nga perspektiva e anëtarëve tanë në industritë e mëposhtme:

1.SIGURIA KIBERNETIKE

Komente nga Perspektiva e Sigurisë Kibernetike nga anëtarë me experiencë ne vendet e ndryshme të Europës.

Pjesa 1: Arsyetimi Strategjik për Integrimin e Sigurisë Kibernetike

- Sigurimi i Hapit Digjital (Paradoksi “e-Albania”):** Dokumenti thekson udhëheqjen e Shqipërisë në shërbimet publike digjitale. Megjithatë, shtyrja e mikro, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (që përbëjnë 99.9% të ekonomisë) drejt adoptimit të Cloud computing, e-commerce dhe Industry 4.0 pa trajnim themelor mbi sigurinë kibernetike do të sjellë domosdoshmërisht cenueshmëri të gjerë ndaj ransomware dhe shkeljeve të të dhënave, duke paralizuar potencialisht infrastrukturën e biznesit.
- Përputhja me Acquis të BE-së & Siguria e Zinxhirit të Furnizimit (NIS2):** Megjithëse drafti referon përputhjen me Direktivën NIS2 nën Objektivin Specifik 1.3, ai dështon ta përkthejë këtë në masa konkrete për NVM-të. Sipas NIS2 dhe kuadrit të ri ligjor kombëtar (Ligji 25/2024), entitetet kritike duhet të sigurojnë sigurinë e të gjithë zinxhirit të furnizimit. NVM-të shqiptare që veprojnë si nënkontraktorë për banka, operatorë telekom, kompani energjie ose institucione shtetërore do të përballen me përjashtim nga tregu nëse nuk përmbushin standardet bazë të sigurisë kibernetike.
- Konkurrueshmëria Globale dhe Gatishmëria për Eksport:** Për t’u integruar me sukses në zinxhirët e vlerës europianë, NVM-të shqiptare duhet të dëshmojnë përputhshmëri teknike dhe operacionale. Siguria kibernetike nuk është më luks; ajo është domosdoshmëri për tregtinë ndërkombëtare.

Pjesa 2: Propozime Operacionale Specifike & Amendamente

Propozoj këto ndryshime konkrete në Masat dhe Instrumentet e planifikuara brenda Objektivit Strategjik 1 (Produktiviteti, Digjitalizimi dhe Inovacioni):

1. Amendament në Masën 1.1.3: “Albanian Digital Skills Hub”

- **Gjendja Aktualë:** Fokus i përgjithshëm në aftësi digjitale bazë dhe të avancuara.
- **Ndryshimi i Propozuar:** Përfshirja eksplicite e një moduli të detyrueshëm mbi Higjienën Kibernetike & Ndërgjegjësimin për Sigurinë për menaxherët dhe punonjësit e NVM-ve.
- **Arsyetimi:** Gabimi njerëzor mbetet vektori kryesor i sulmeve kibernetike (phishing, social engineering). Ndërtimi i ndërgjegjësimit bazë është mënyra më me kosto efektive për të mbrojtur bizneset e vogla.

2. Amendament në Masën 1.1.1: “Regjistri Kombëtar i Konsulentëve të Certifikuar të Biznesit”

- **Gjendja Aktualë:** Krijon një regjistër të konsulentëve standard të zhvillimit të biznesit.
- **Ndryshimi i Propozuar:** Krijimi i një nën-kategorie të dedikuar për “Konsulentë të Sigurisë Kibernetike & Përputhshmërisë Rregullatore” (mbulon NIS2, DORA dhe Ligjin Kombëtar 25/2024).
- **Arsyetimi:** NVM-të kërkojnë udhëzime teknike dhe ligjore të specializuara për të naviguar në mënyrë të sigurt peizazhin kompleks rregullator digjital.

3. Amendament në Instrumentet Financiare (Masa 1.2.2 & Masa 1.5.1 - Vouchers për Inovacion Digjital)

- **Gjendja Aktualë:** Vouchers mbështesin zgjidhje teknike të përgjithshme, ndërkombëtarizimin dhe transferimin e teknologjisë.
- **Ndryshimi i Propozuar:** Përcaktimi eksplicit i Auditimeve të Sigurisë IT, Testimeve të Penetrimit dhe blerjes së softuerëve bazë të sigurisë (p.sh., Firewalls, EDR, Endpoint Protection dhe sisteme rezervë të automatizuara) si kosto të pranueshme nën të gjitha Vouchers për Inovacion Digjital dhe Mbështetje për NVM-të.
- **Arsyetimi:** Kufizimet financiare pengojnë NVM-të të investojnë në siguri. Bashkëfinancimi i vlerësimit fillestar dhe mjeteve bazë të mbrojtjes do të reduktojë ndjeshëm cenueshmërinë kibernetike kombëtare.

4. Koordinimi Institucional: Rritja e Rol-it të AKSK

- **Gjendja Aktualë:** Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKSK) është listuar vetëm si institucion pjesëmarrës pasiv.
- **Ndryshimi i Propozuar:** Rritja e AKSK në partner bashkë-dizajnuar dhe monitorues krahas AIDA dhe AKSHI për të gjitha iniciativat e digjitalizimit të NVM-ve. Zbatimi i një liste kontrolli “Security by Design” për çdo projekt modernizimi IT të NVM-ve të financuar nga shteti.

2.INDUSTRIA E NDERTIMIT

Komente dhe Sugjerime mbi Strategjinë për Zhvillimin Industrial, Minerar dhe të Eksporteve

1. Energjia dhe Konkurrueshmëria Industriale

Energjia është trajtuar në draft kryesisht në kuadër të eficiencës energjetike, dekarbonizimit dhe ekonomisë qarkulluese. Megjithatë, kostoja e energjisë si faktor kyç i konkurrueshmërisë së industrisë nuk trajtohet në mënyrë të qartë dhe duhet të përfshihet në mënyrë më të plotë në strategji.

Për sektorët minerarë, përpunues dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit, energjia përfaqëson një nga kostot kryesore të prodhimit. Për këtë arsye, strategjia duhet të adresojë:

- Konkurrueshmërinë energjetike të industrisë
- Aksesin e ndërmarrjeve në kontrata afatgjata të energjisë me cmim konkurrues
- Mekanizma mbështetës për reduktimin e kostove energjetike.
- Procedurat për vetëprodhimin e energjisë nga bizneset industriale
- Mbështetjen e investimeve në eficiencë energjetike dhe teknologji me konsum të ulët energjie.

Propozim Konkret

Të parashikohet një program kombëtar mbështetjeje nga Ministria përgjegjëse për Energjinë për:

- Linja të dedikuara për furnizimin me gaz, ose energji elektrike të investuara nga shteti. Aktivizim i linjës së furnizimit me gaz në zona si Finiq, Korce, Berat, Vlore ose të tjera – pranë vendodhjeve të aktiviteteve minerale ose industriale – Përfshirje me plan zbatimi dhe afate kohore konkrete me grup pune të dedikuar të Ministrisë Energjetike dhe Infrastruktura.
- Subvencionimin e investimeve në panele fotovoltaike, ose energji të rinovueshme, për të gjithë sektorin sidomos sektorin përpunues/prodhues.
- Mbështetjen financiare për instalimin e sistemeve të magazinimit të energjisë (bateri industriale).
- Lehtësimin e procedurave për vetëprodhuesit industrial (Pannele solare). Përfshirje dhe plan zbatimi dhe afate konkrete me grupe pune të dedikuara të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastruktura, OSHEE, etj institucione në varesi.

Ky program do të reduktonte kostot operative të industrisë, do të rriste konkurrueshmërinë e eksporteve dhe do të kontribuonte në objektivat e dekarbonizimit.

2. Infrastruktura Industriale dhe Zonat Minerare

Kjo temë trajtohet në mënyrë të kufizuar në draft, megjithëse përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të industrisë dhe sektorit minerar në Shqipëri.

Për vendet me potencial minerar, infrastruktura nuk është vetëm një element mbështetës, por një parakusht për investime, rritjen e prodhimit dhe rritjen e eksporteve.

Strategjia duhet të përfshijë një program të qartë për zhvillimin e infrastrukturës industriale dhe minerare, duke adresuar:

- Zhvillimin dhe rehabilitimin e rrugëve industriale dhe minerare, dhe të administruara nga pushteti qendror, për të garantuar akses të qëndrueshëm në zonat prodhuese, minerare dhe eksportuese.
 - Hapa konkret për kalimin e akeseve në zona industriale nga administrimi I bashkive lokale në mbikqyrjen dhe administrimin e Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastruktës, me ndërtimin e hartës së plote të zonave industriale, vlerësimin e kushteve aktuale të infrastruktures dhe me planin konkret me afatë për përmirësimin e kushteve dhe zgjerimeve të nevojshme, si dhe nderhyrjeve për mbrojtjen e eco-sistemit dhe mbrojtjen e biodiversitetit në rrugë kalimet e transportit të zonave minerare dhe industriale.
- Modernizimin e lidhjeve rrugore me zonat e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve.
- Përmirësimin e infrastrukturës së eksportit dhe lidhjen e saj me korridoret kryesore kombëtare dhe rajonale.
- Sigurimin e furnizimit me ujë industrial (I riciklikuar) për zonat prodhuese dhe industriale.
- Garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike për zonat minerare dhe përpunuese.
- Zgjerimin e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë në zonat me potencial industrial.
- Krijimin e planteve të riciklimit të ujërave dhe financimit të tyre, me plan konkret sipas zonave industriale duke grumbulluar dhe rishpërndarë për funksion të akvitetit industrial dhe në kuadrin e Ekonomisë Qarkulluese. Përfshirje konkrete e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Ekonomisë, dhe Energjisë dhe Infrastruktës dhe enteve në varesi, me plan zbatimi dhe afatë konkrete.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zonave me potencial të lartë mineral, ku shpesh investimet pengohen nga mungesa e rrugëve të përshtatshme, kapacitetet e kufizuara energjetike, mungesa e ujit industrial dhe kostot e larta logjistike. Adresimi i këtyre sfidave do të rriste ndjeshëm atraktivitetin e vendit për investitorët vendas dhe të huaj.

Gjithashtu, strategjia duhet të parashikojë zhvillimin e **parqeve industriale dhe minerare të integruara**, ku aktivitetet e përpunimit, magazinimit, logistikës dhe eksportit të jenë të përqendruara në të njëjtën zonë. Kjo do të krijonte ekonomi shkallë, do të ulte kostot operative dhe do të rriste vlerën e shtuar të produkteve shqiptare.

3. Logjistika Portuale dhe Infrastrukturat Portuale

Logjistika portuale është trajtuar në draft vetëm në mënyrë të përgjithshme, ndërkohë që për sektorët eksportues ajo përbën një element strategjik të zinxhirit të vlerës. Për sektorët e kromit, bakrit, gipsit, çimentos dhe materialeve të ndërtimit, porti nuk është thjesht një pikë transporti, por një komponent thelbësor i procesit të prodhimit, magazinimit dhe eksportit.

Duke pasur parasysh rolin e sektorit mineral dhe përpunues në ekonominë shqiptare, strategjia duhet të trajtojë në mënyrë të dedikuar zhvillimin e infrastrukturës portuale si një faktor kyç për rritjen e konkurrueshmërisë së eksporteve shqiptare dhe tërheqjen e investimeve të reja industriale.

Zhvillimi i Kapaciteteve Portuale

Strategjia duhet të parashikojë:

- Zgjerimin e terminaleve të porteve ekzistuese për ngarkesat industriale dhe minerare dhe zgjerimin e akeseve në porte të reja si Saranda apo Shengjini etj. Plan Konkret me afatë dhe ndëjkje zbatimi me ekip të dedikuar të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastruktës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë
- Rritjen e kapaciteteve të magazinimit portual për lëndë të para dhe produkte të përpunuara.
- Krijimin e terminaleve të dedikuara për minerale, materiale ndërtimi dhe ngarkesa industriale me volum të lartë si Saranda, Shengjini etj.

- Instalimin e sistemeve moderne të ngarkim-shkarkimit me produktivitet të lartë. Ne shumicën e porteve mungojnë.
- Investime në infrastrukturën ndihmëse për përpunimin, klasifikimin dhe përgatitjen e produkteve për eksport. Mjetet mandatori për porte industriale funksionale, Eskavator, Pirun, Vinc, etj – plan konkret plotësimi mjeteve operacionale në porte industriale ekzistuese dhe integrim i të gjithë sistemit në porte të reja.

Integrimi Minierë – Industri – Port

Konkurrueshmëria e eksporteve nuk varet vetëm nga portet, por nga efikasiteti i gjithë zinxhirit logjistik.

Për këtë arsye strategjia duhet të mbështesë:

- Ndërtimin dhe modernizimin e korridoreve të eksportit, rruge alternative jashtë zonave të banuara me akses të drejtpërdrejtë të zonave minerare dhe industriale me portet kryesore.
- Zhvillimin e nyjeve logjistike për grumbullimin, magazinimin dhe përpunimin paraprak të mallrave për eksport, pa kosto të shtuar.
- Përmirësimin e koordinimit ndërmjet operatorëve portualë, industrisë dhe transportuesve. Aktualisht e gjithë barra e operimit qëndron tek prodhuesit, strategjia duhet të adresojë mirëfunksionimin dhe alternativat e të gjithë zinxhirit minierë-industri perpunuese-port.

Integrimi me Korridoret Rajonale

Për të rritur rolin e Shqipërisë si nyje logjistike rajonale, strategjia duhet të parashikojë:

- Lidhje më të forta me Korridorin VIII;
- Integrimin me rrjetet evropiane të transportit dhe logjistikës;
- Përmirësimin e lidhjeve rrugore dhe plan për transport hekurudhor me portet. Ndërtimi i linjave të trenit për transporte me eficientë në kosto sidomos të lendeve të para si brenda territorit (miniere – perpunues lokal – port eksporte) ashtu dhe me vendet fqinje si Greqi, Kosovë etj
- Zhvillimin e porteve industriale si pika strategjike për tregtinë e Ballkanit Perëndimor.

Kostoja dhe Konkurrueshmëria Portuale

Një element shumë i rëndësishëm që aktualisht nuk trajtohet në draft është niveli i kostove portuale dhe ndikimi i tyre në konkurrueshmërinë e eksporteve shqiptare.

Strategjia duhet të përfshijë masa për:

- Rishikim i kostove portuale për eksportuesit e lendeve të para dhe industrinë perpunuese, me synim konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare. Kostot aktuale shumë të larta për ton/ masë të menjëhershme në rishikimin e kostove në të gjithë portet aktuale. – Plan konkret pune dhe transparencë të kontratave koncensionare dhe kushteve të ofrimit të shërbimit për eksportuesit e industrisë.
- Plan konkret dhe i detajuar i rishikimit të të gjithë kontratave koncensionare të manaxhimit të porteve dhe të rishikimit të të gjithë parashikimeve dhe afateve për plotësimin e kushteve dhe mjeteve operacionale për lehtësimin e proceseve të magazinimit-perpunim-ngarkim në funksion të eficientës së eksportuesve.

Për sektorët industrialë dhe minerarë, ulja e kostove portuale përkthehet drejtpërdrejt në rritje të konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare dhe në rritje të investimeve në përpunimin vendas.

Një qasje e tillë do ta trajtonte portin jo vetëm si infrastrukturë transporti, por si një aset strategjik kombëtar për zhvillimin industrial, rritjen e eksporteve dhe integrimin e Shqipërisë në zinxhirët rajonalë dhe evropianë të furnizimit

4. Përpunimi në Vend i Lëndëve të Para

Strategjia përmend kromin, bakrin, nikelin dhe Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike, por fokusohet kryesisht tek zinxhirët e furnizimit dhe integrimi në tregun evropian

Mungojnë objektiva konkrete që lidhen me:

- Përqindjen e mineralit që duhet të përpunohet në Shqipëri.
- Ngritjen e impianteve të reja të përpunimit.
- Rritjen e investimeve në industrinë përpunuese minerare.

Sugjerime

- Lehtësira fiskale për investimet në përpunimin vendas për të stimuluar përpunim në vend të lëndëve të para.
- Procedura të përsheptuara, për lejet e ndërtimit, dergimin e infrastrukturës së nevojshme dhe licencim.
- Skema mbështetëse për ndërmarrjet përpunuese që nuk klasifikohen si investitorë strategjikë.

5. Mineralet Kritike dhe Autonomia Strategjike e BE-së

Tema është trajtuar në nivel strategjik, por mungojnë mekanizmat konkretë të zbatimit.

Sugjerohet krijimi i një programi kombëtar të dedikuar për:

- Zhvillimin e zinxhirit të vlerës së mineraleve kritike. Plan konkret, mapimin, hartifikimin e të gjithë burimeve me minerale kritike me hapa konkret kerkim-zbulim-dhe dokumentim. Azhurnim i hartave ekzistuese me të dhëna të reja konkrete digjitale të aksesueshme për çdo investitor potencial. Grup pune i dedikuar Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Energjisë dhe Infrastruktës
- Tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendase në përpunimin e tyre.
- Zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe kualifikimeve profesionale.

Ky program do të ndihmonte transformimin e potencialit minerar në investime reale dhe vende pune me vlerë të shtuar.

6. Standardet dhe Konkurrenca e Ndershme

Në praktikë, kompanitë që investojnë në teknologji moderne, siguri në punë, mbrojtje të mjedisit dhe certifikime europiane përballen shpesh me kosto më të larta krahasuar me operatorët që nuk i zbatojnë plotësisht këto standarde.

Prandaj strategjia duhet të përcjellë qartë parimin:

"I njëjti standard duhet të zbatohet për të gjithë operatorët ekonomikë."

Kjo mund të integrohet në kapitullin:

"Fuqizimi i standardeve dhe i infrastrukturës së cilësisë për gatishmërinë ndaj Tregut të Vetëm të BE-së".

Kjo do të kontribuonte në:

- Konkurrencë të ndershme.
- Cilësi më të lartë të produkteve.
- Mbrojtje më të mirë të mjedisit.
- Rritjen e besimit të investitorëve dhe partnerëve europianë.

Konkluzion

Strategjia paraqet një vizion pozitiv për zhvillimin e industrisë dhe sektorit minerar në Shqipëri, duke adresuar sfida dhe mundësi të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe integrimin në tregjet evropiane. Megjithatë, dokumenti do të përfitonte nga përcaktimi i objektivave më konkrete dhe masave më të qarta për zbatim në fusha kyçe si konkurrueshmëria energjetike, zhvillimi i industrisë përpunuese, infrastruktura industriale dhe minerare, logjistika dhe infrastruktura portuale, zhvillimi i zinxhirit të vlerës së mineraleve kritike, si dhe garantimi i zbatimit të barabartë të standardeve për të gjithë operatorët ekonomikë.

Përfshirja e objektivave të matshëm, mekanizmave të monitorimit dhe instrumenteve konkrete mbështetëse do ta bënte strategjinë më efektive, më të zbatueshme dhe më të orientuar drejt rezultateve, duke kontribuar në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, rritjen e eksporteve, përpunimin e lëndëve të para me vlerë të shtuar brenda vendit dhe tërheqjen e investimeve afatgjata në sektorët industrialë dhe minerarë

Ndertimi I nje plani konkret me listen e stadarteve qe duhet te permbushin prodhuesit aktual (health-check), me nje vleresim te detajuar perputhshmerie sipas kushteve aktuale dhe me afate konkrete te permbushjes se tyre pa penalitetet me terma kohore te barabarte per te gjithë aktoret sipas sektoreve respective, perfshi subvencionet per perputhshmeri. Cdo mosperputhje pertej afateve te parashikuar te shoqerohet me masa administrative.

Rishikimi I legjislacionit Fiskal, Tatimor, I procedurave te auditimit, I forcimit te cilesise se raportimit financiar dhe I forcimit te penaliteve ne kohe dhe ne vlere per te imponuar standard te drejtet te aktiviteve ekonomike dhe raportimeve financiare.

Strategjia duhet te perfshije plan dhe afate konkrete ne bashkepunim me Ministrine e Financave, Drejtorine e pergjithshme te tatimeve, FIAA, Autoritetin e Konkurences, etj

Ndërhyrja e menjëhershme për përmirësimin e klimës së biznesit është thelbësore për ndërtimin e një ekonomie të shëndetshme dhe konkurruese. Rishikim i politikave aktuale tatimore, zbatimi i praktikave tatimore dhe fiskale në përputhje me standardet evropiane, forcimi i mbikëqyrjes financiare dhe izolimi i rasteve të abuzimit me legjislacionin, si ne model operimi si dhe raportim, janë kushte të domosdoshme për të garantuar konkurrencë të ndershme, për të përmirësuar likuiditetin, veçanërisht në sektorët kritikë, dhe për të mbrojtur investimet ekzistuese e për tërhequr investime të reja. Çdo investitor që operon me transparencë, respekton ligjin dhe standardet duhet të ketë garancinë se do të konkurrojë në një treg të drejtë, ku suksesi përcaktohet nga performanca dhe jo nga shmangia e rregullave. Kjo kërkon reflektim institucional dhe veprim të menjëhershëm.

Te behen menjehere ndryshimet e procedures se Titullit Ekzekutiv i cili indirekt ne aplikim do te fillore riedukim financiar te detyruar te te gjithë operatoreve dhe zinxhirit te furnizimit dhe do te synoje drejtimin e tyre ndrejt institucioneve financiare. Te merren praktikat rajonale Kosova etj.. dhe te nderhyhet sa me pare me ndryshimet ligjore perkatese.

3. INDUSTRIA E ÇIMENTOS

Relacion për draftin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030

Në lidhje me draftin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030, vlerësojmë pozitivisht fokusin e dokumentit mbi dekarbonizimin industrial, ekonominë qarkulluese, rritjen e konkurrueshmërisë dhe integrimin në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Europian.

Megjithatë, për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie dhe emetimesh, si industria e çimentos, draft-strategjia mbetet kryesisht në nivel objektivash të përgjithshme dhe nuk adreson mjaftueshëm kushtet konkrete që kërkojnë për zbatimin praktik të dekarbonizimit, ekonominë qarkulluese dhe përshtatjes me kërkesat e Mekanizmit të Rregullimit të Karbonit në Kufi (CBAM).

Për industrinë e çimentos, dekarbonizimi nuk mund të mbështetet vetëm në objektiva horizontale. Ai kërkon masa sektoriale për nxitjen e prodhimit vendas dhe përdorimin e karburanteve alternative RDF/SRF, zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm vendas për këto materiale, qartësimin e kuadrit rregullator për përdorimin dhe importin e tyre kur furnizimi vendas është i pamjaftueshëm, si dhe njohjen e bashkëdjegies/co-incineration si instrument i rëndësishëm për reduktimin e emetimeve dhe zbatimin e ekonomisë qarkulluese.

Aktualisht, mungesa e një tregu funksional për RDF/SRF në Shqipëri dhe kufizimet praktike ose rregullatore për importin e tyre krijojnë disavantazh konkurrues për industrinë shqiptare të çimentos kundrejt prodhuesve në Bashkimin Europian, të cilët kanë akses të konsoliduar në karburante alternative, materiale sekondare, instrumente financiare dhe kuadër më të qartë rregullator për dekarbonizimin industrial.

Në këtë kontekst, sugjerohet që strategjia të plotësohet me masa më konkrete për sektorët me intensitet të lartë energjie, duke përfshirë veçanërisht industrinë e çimentos. Për këtë qëllim, dokumenti duhet të marrë në konsideratë:

- nxitjen e prodhimit vendas dhe zhvillimin e një tregu funksional për karburantet alternative RDF/SRF, të prodhuara nga mbetje jo të riciklueshme dhe të përshtatshme për përdorim industrial;
- qartësimin dhe përafrimin e kuadrit rregullator për përdorimin e RDF/SRF të prodhuara në vend, si dhe për importin e tyre vetëm si mundësi plotësuese, në përputhje me praktikën e Bashkimit Europian, kur tregu vendas nuk siguron ende sasi dhe cilësi të mjaftueshme;
- njohjen e karburanteve alternative, materialeve sekondare dhe bashkëdjegies si pjesë integrale të udhërrëfyesit të dekarbonizimit për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie dhe emetimesh;
- parashikimin e instrumenteve financiare dhe teknike për investime në dekarbonizim, efikasitet energjetike, monitorim të emetimeve, përdorim të karburanteve alternative dhe zbatim të ekonomisë qarkulluese në industri.

Përfshirja e këtyre elementeve do të rriste realizueshmërinë e objektivave të strategjisë, do të përmirësonte konkurrueshmërinë e industrisë vendase dhe do ta përgatiste më mirë sektorin e çimentos për kërkesat e tregut europian, përfshirë CBAM.

Për zbatimin efektiv të masave të propozuara, është e rëndësishme që Strategjia Industriale të koordinohet me politikat mjedisore, të mbetjeve dhe të klimës, në mënyrë që objektivat ekonomike, industriale dhe mjedisore të jenë të harmonizuara dhe të mbështesin njëri-tjetrin në praktikë.

Aneks: Komente dhe amendime të propozuara për draft-strategjinë

1. Kapitulli 3 – Qëllimi Strategjik 1: Transformimi i sistemeve të prodhimit

Qëllimi Strategjik 1 – Transformimi i sistemeve të prodhimit

1.1 Objektivi Specifik 1.2 – Produktiviteti i burimeve, dekarbonizimi dhe praktikat qarkulluese të prodhimit

Propozim për seksionin “Analiza e situatës”

Shtohet paragrafi:

Një kufizim strukturor për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie, veçanërisht për industrinë e çimentos, lidhet me mungesën e aksesit në karburante alternative jo fosile si RDF/SRF. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një tregu vendas funksional për këto materiale dhe i paqartësive ose kufizimeve rregullatore për përdorimin dhe importin e tyre. Ky faktor kufizon aftësinë e industrisë për të reduktuar emetimet, për të zbatuar trajektoret e dekarbonizimit dhe për t'u përshtatur me kërkesat e CBAM, duke ndikuar negativisht në konkurrueshmërinë e saj kundrejt industrisë së Bashkimit Europian.

Në këtë drejtim, praktika e industrisë së çimentos në Bashkimin Europian tregon se zëvendësimi gradual i lëndëve djegëse fosile me karburante alternative është një nga rrugët kryesore të dekarbonizimit të sektorit. Për këtë arsye, Strategjia Industriale duhet të orientojë edhe industrinë vendase drejt krijimit të kushteve për prodhimin, përdorimin dhe rritjen progresive të karburanteve alternative, në përputhje me praktikat europiane.

Propozim për seksionin “Sfidat”

Shtohen këto dy pika:

- Mungesa e një tregu funksional vendas për karburante alternative RDF/SRF dhe materiale sekondare të përshtatshme për përdorim në sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie.
- Paqartësitë rregullatore për përdorimin, importin dhe bashkëdjegien e RDF/SRF, të cilat kufizojnë zbatimin praktik të ekonomisë qarkulluese dhe dekarbonizimit në industrinë e çimentos.

Propozim për masën 1.2.1

Të parashikohet mbështetje për zhvillimin, prodhimin vendas dhe përdorimin e karburanteve alternative dhe materialeve sekondare, përfshirë RDF/SRF, në proceset industriale me intensitet të lartë energjie. Kjo mbështetje duhet të përfshijë krijimin e tregut vendas, nxitjen e investimeve për përpunimin e mbetjeve jo të riciklueshme në RDF/SRF, përafrimin e kuadrit rregullator me praktikën e BE-së, mundësimin e importit vetëm kur furnizimi vendas është i pamjaftueshëm, si dhe nxitjen e investimeve që kontribuojnë në reduktimin e emetimeve dhe rritjen e efijencës së burimeve.

2. Kapitulli 3 – Qëllimi Strategjik 2: Integrimi në ekosistemet evropiane dhe zinxhirët e vlerës

2.1 Lidhja ndërmjet dekarbonizimit, CBAM dhe konkurrueshmërisë në zinxhirët e vlerës

Përafrimi me kërkesat e tregut të Bashkimit Europian dhe integrimi në zinxhirët evropianë të vlerës kërkon që sektorët industrialë të ekspozuar ndaj CBAM, përfshirë industrinë e çimentos, të kenë akses në zgjidhje efektive për dekarbonizim. Karburantet alternative si RDF/SRF dhe materialet sekondare përbëjnë instrumente kyçe për reduktimin e emetimeve, zbatimin e ekonomisë qarkulluese dhe ruajtjen e konkurrueshmërisë së industrisë vendase.

2.2 Objektivi Specifik 2.1 – Integrimi në zinxhirët e vlerës

Mungesa e aksesit në zgjidhje efektive të dekarbonizimit, përfshirë përdorimin e karburanteve alternative RDF/SRF, mund të krijojë barriera shtesë për integrimin e industrisë shqiptare në zinxhirët e vlerës të Bashkimit European, veçanërisht në kuadër të kërkesave ESG, CBAM dhe standardeve të qëndrueshmërisë në zinxhirët e furnizimit.

3. Kapitulli 3 – Objektivi Specifik 1.2: Lidhja me CBAM

Objektivi Strategjik 1.2 – lidhja me CBAM

Kufizimet aktuale në aksesin ndaj RDF/SRF, materialeve sekondare dhe instrumenteve financiare për dekarbonizim ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e industrisë shqiptare për CBAM. Në mungesë të masave konkrete, sektorë si industria e çimentos rrezikojnë të përballen me kosto shtesë dhe humbje konkurrueshmërie kundrejt prodhuesve të BE-së që kanë akses më të mirë në teknologji, karburante alternative dhe mbështetje financiare.

4. Kapitulli 3 – Qëllimi Strategjik 2 / Objektivi Specifik 2.3: Vlerësimi i ndikimit rregullator dhe konkurrueshmëria industriale

Përafrimi me trajektoret e dekarbonizimit të Bashkimit European kërkon jo vetëm objektiva strategjike, por edhe zhvillimin e kushteve mundësuese për zbatimin e tyre në praktikë. Për këtë arsye, çdo masë fiskale, mjedisore ose rregullatore që mund të rrisë ndjeshëm kostot e prodhimit për ndërmarrjet industriale duhet të shoqërohet paraprakisht me një vlerësim të ndikimit në konkurrueshmëri.

Ky vlerësim duhet të analizojë efektet në kostot e prodhimit, konkurrueshmërinë e prodhuesve vendas ndaj importeve dhe në tregjet e eksportit, aftësinë e ndërmarrjeve për t'u përshtatur, si dhe nevojën për periudha tranzitore ose masa mbështetëse.

Masat përkatëse duhet të jenë të parashikueshme, proporcionale, të fazuara kur është e nevojshme dhe të përafruara me praktikën e Bashkimit European, në mënyrë që tranzicioni i gjelbër dhe përputhja rregullatore të mos dëmtojnë konkurrueshmërinë e prodhimit vendas.

5. Kapitulli 3 – Objektivi Specifik 1.2: Financimi i tranzicionit të gjelbër dhe dekarbonizimit industrial

Sugjerojmë që Strategjia Kombëtare Industriale të parashikojë instrumente më konkrete financiare për mbështetjen e investimeve që lidhen me dekarbonizimin, eficiencën energjetike, ekonominë qarkulluese, monitorimin e emetimeve, përdorimin e karburanteve alternative dhe përshtatjen me kërkesat e BE-së.

Për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie dhe kapitali, tranzicioni i gjelbër kërkon investime të rëndësishme në teknologji, procese prodhuese, sisteme monitorimi, infrastrukturë dhe zgjidhje alternative për furnizimin me energji dhe lëndë djegëse. Për këtë arsye, masat rregullatore duhet të shoqërohen me instrumente mbështetëse si skema garancie, bashkëfinancim, kredi me kushte të favorshme, asistencë teknike dhe akses më të strukturuar në fondet e Bashkimit European dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Sigurimi i këtyre instrumenteve është thelbësor për të garantuar që objektivat e dekarbonizimit dhe të tranzicionit të gjelbër të jenë të zbatueshme në praktikë dhe të mos kthehen në kosto shtesë të papërballueshme për industrinë.

Relacion për draftin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030

Në lidhje me draftin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030, vlerësojmë pozitivisht fokusin e dokumentit mbi dekarbonizimin industrial, ekonominë qarkulluese, rritjen e konkurrueshmërisë dhe integrimin në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Europian.

Megjithatë, për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie dhe emetimesh, si industria e çimentos, draft-strategjia mbetet kryesisht në nivel objektivash të përgjithshme dhe nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme kushtet konkrete që nevojiten për zbatimin praktik të tranzicionit të gjelbër, ekonominë qarkulluese dhe përshtatjes me kërkesat e Mekanizmit të Rregullimit të Karbonit në Kufi (CBAM).

Për industritë e vështira për t'u dekarbonizuar (hard-to-abate industries), dekarbonizimi nuk mund të mbështetet vetëm në objektiva horizontale. Ai kërkon masa sektoriale që krijojnë kushtet mundësuese për reduktimin e emetimeve, përfshirë zhvillimin e tregjeve për karburante alternative, përdorimin e materialeve sekondare, përmirësimin e eficiencës së burimeve, aksesin në energji konkurruese dhe mbështetjen për investimet teknologjike.

Për industrinë e çimentos, një nga instrumentet kryesore të dekarbonizimit është zëvendësimi gradual i lëndëve djegëse fosile me karburante alternative jo fosile si RDF/SRF, të prodhuara nga fraksione mbetjesh që nuk mund të riciklohen ose ripërdoren, në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe praktikën e Bashkimit Europian.

Aktualisht, mungesa e një tregu funksional vendas për RDF/SRF dhe paqartësitë ose kufizimet praktike dhe rregullatore për përdorimin dhe sigurimin e tyre krijojnë pengesa për zbatimin e ekonominë qarkulluese dhe reduktimin e emetimeve industriale. Kjo ndikon në përgatitjen e industrisë vendase ndaj kërkesave të CBAM dhe krijon disavantazh konkurrues krahasuar me prodhuesit në Bashkimin Europian, të cilët kanë akses më të konsoliduar në karburante alternative, materiale sekondare, teknologji dhe instrumente financiare për dekarbonizim.

Në këtë kontekst, Strategjia Industriale duhet të konsiderojë krijimin e kushteve për një tranzicion industrial të qëndrueshëm, duke përfshirë:

- nxitjen e prodhimit vendas dhe zhvillimin e një tregu funksional për karburante alternative RDF/SRF të prodhuara nga mbetje jo të riciklueshme dhe të përshtatshme për përdorim industrial;
- krijimin e një kuadri të qartë rregullator për përdorimin e RDF/SRF të prodhuara në vend, si dhe mundësimin e burimeve alternative të furnizimit, përfshirë importin e kontrolluar dhe të justifikuar teknikisht kur kapacitetet vendase nuk sigurojnë sasi dhe cilësi të përshtatshme;
- njohjen e karburanteve alternative, materialeve sekondare dhe bashkëdjegies (co-incineration) si pjesë integrale të trajektoreve të dekarbonizimit për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie dhe emetimesh;
- mbështetjen e inovacionit në proceset e prodhimit të çimentos, përfshirë optimizimin e përdorimit të klinkerit, përdorimin e materialeve sekondare dhe zhvillimin e produkteve me intensitet më të ulët karboni;
- sigurimin e aksesit në energji konkurruese, të qëndrueshme dhe me gjurmë të reduktuar karboni, si një element thelbësor për ruajtjen e konkurrueshmërisë së industrive me intensitet të lartë energjie;
- parashikimin e instrumenteve financiare dhe teknike për investime në dekarbonizim, eficiencë energjetike, monitorim të emetimeve, përdorim të karburanteve alternative dhe zbatim të ekonominë qarkulluese në industri.

Përfshirja e këtyre elementeve do të rriste realizueshmërinë e objektivave të Strategjisë Kombëtare Industriale, do të përmirësonte konkurrueshmërinë e industrisë vendase dhe do të kontribuonte në përgatitjen e sektorëve industrialë për kërkesat e tregut europian, përfshirë CBAM, duke reduktuar gjithashtu rrezikun e zhvendosjes së prodhimit drejt tregjeve me standarde më të ulëta mjedisore (carbon leakage).

Aneks: Komente dhe amendime të propozuara për draft-strategjinë

1. Kapitulli 3 – Qëllimi Strategjik 1: Transformimi i sistemeve të prodhimit

1.1 Objektivi Specifik 1.2 – Produktiviteti i burimeve, dekarbonizimi dhe praktikat qarkulluese të prodhimit

Propozim për seksionin “Analiza e situatës”

Të shtohet:

Një kufizim strukturor për sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie, veçanërisht për industrinë e çimentos, lidhet me mungesën e aksesit në karburante alternative jo fosile si RDF/SRF dhe materiale sekondare të përshtatshme për përdorim industrial. Kjo lidhet me mungesën e një tregu vendas funksional dhe me nevojën për qartësim të mëtejshëm të kuadrit rregullator për përdorimin e tyre.

Në industrinë europiane të çimentos, zëvendësimi gradual i lëndëve djegëse fosile me karburante alternative është një nga rrugët kryesore të reduktimit të emetimeve. Për këtë arsye, Strategjia Industriale duhet të krijojë kushtet për zhvillimin e prodhimit, përdorimit dhe furnizimit të qëndrueshëm me karburante alternative, në përputhje me praktikën europiane dhe hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

Propozim për seksionin “Sfidat”

Të shtohen:

- Mungesa e një tregu funksional vendas për karburante alternative RDF/SRF dhe materiale sekondare të përshtatshme për përdorim në sektorët industrialë me intensitet të lartë energjie.
- Paqartësitë rregullatore për përdorimin, sigurimin dhe bashkëdjegjen e RDF/SRF, të cilat kufizojnë zbatimin praktik të ekonomisë qarkulluese dhe dekarbonizimit industrial.

Propozim për masën 1.2.1

Të parashikohet mbështetje për zhvillimin, prodhimin vendas dhe përdorimin e karburanteve alternative dhe materialeve sekondare në proceset industriale me intensitet të lartë energjie.

Kjo duhet të përfshijë krijimin e tregut vendas, nxitjen e investimeve për përpunimin e mbetjeve jo të riciklueshme në RDF/SRF, përafrimin e kuadrit rregullator me praktikën e BE-së, mundësimin e burimeve plotësuese të furnizimit kur kapacitetet vendase janë të pamjaftueshme dhe mbështetjen e investimeve që kontribuojnë në reduktimin e emetimeve dhe rritjen e eficiencës së burimeve.

2. Qëllimi Strategjik 2 – Integrimi në ekosistemet europiane dhe zinxhirët e vlerës

Përafrimi me kërkesat e tregut të Bashkimit Europian dhe integrimi në zinxhirët europianë të vlerës kërkon që sektorët industrialë të ekspozuar ndaj CBAM të kenë akses në zgjidhje efektive për dekarbonizim.

Mungesa e aksesit në karburante alternative, materiale sekondare, teknologji dhe instrumente financiare mund të krijojë barriera shtesë për konkurrueshmërinë dhe integrimin e industrisë shqiptare në zinxhirët europianë të vlerës.

3. Objektivi Specifik 1.2 – Lidhja me CBAM

Kufizimet aktuale në aksesin ndaj zgjidhjeve të dekarbonizimit ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e industrisë shqiptare për CBAM. Për këtë arsye, masat e tranzicionit industrial duhet të shoqërohen me politika mbështetëse që sigurojnë konkurrueshmëri dhe shmangin rritjen disproporcionale të kostove të prodhimit.

4. Objektivi Specifik 2.3 – Vlerësimi i ndikimit rregullator dhe konkurrueshmëria industriale

Çdo masë fiskale, mjedisore ose rregullatore që ndikon ndjeshëm në kostot e prodhimit të ndërmarrjeve industriale duhet të shoqërohet me një vlerësim paraprak të ndikimit në konkurrueshmëri.

Ky vlerësim duhet të analizojë efektet në kostot e prodhimit, konkurrueshmërinë ndaj importeve dhe tregjeve të eksportit, aftësinë e ndërmarrjeve për t'u përshtatur, si dhe nevojën për periudha tranzitore ose masa mbështetëse.

5. Financimi i tranzicionit të gjelbër dhe dekarbonizimit industrial

Strategjia Kombëtare Industriale duhet të parashikojë instrumente konkrete financiare për mbështetjen e investimeve në dekarbonizim, eficiencë energjetike, ekonomi qarkulluese, monitorim të emetimeve, karburante alternative dhe përshtatje me kërkesat e BE-së.

Për industritë me intensitet të lartë energjie dhe kapitali, tranzicioni i gjelbër kërkon investime të konsiderueshme në teknologji, procese prodhuese, infrastrukturë dhe sisteme monitorimi. Për këtë arsye nevojiten instrumente si skema garancie, bashkëfinancim, kredi me kushte të favorshme, asistencë teknike dhe akses më i strukturuar në fondet e Bashkimit European dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Sigurimi i këtyre instrumenteve është thelbësor për të garantuar që objektivat e dekarbonizimit dhe tranzicionit të gjelbër të jenë të realizueshme në praktikë dhe të mbështesin konkurrueshmërinë afatgjatë të industrisë vendase.

4. INDUSTRIA AGRO USHQIMORE

Në lidhje me RENJK 987 Strategjia Kombëtare e Industrisë

Një hap i mirë, me disa shënime/pyetje:

Financimi i tranzicionit – Cilat mekanizma konkretë financiarë do të mbështesin investimet industriale—lehtësime tatimore, grante, apo bashkë-financim, veçanërisht për transformimin e Gjellbër & Digjital? Nevojitet bashkë-financim i kapex-it dhe mbështetje për modernizim. **Angazhimet për infrastrukturën** – Cilat janë afatet dhe investimet e angazhuara për energjinë, ujin dhe infrastrukturën logjistike? Si do të ndihmojë qeveria në krijimin e aksesit më të lehtë në burimet e qendrave urbane përmes transportit masiv? Strategjia supozon: energji, ujë dhe logjistikë të besueshme.

Thjeshtimi rregullator – Si do të zbatohet përafrimi me BE pa rritur barrën administrative për bizneset? Si do të komunikohen vendimarrjet, të thjeshtohen dhe të përshpejtohen? **Zhvillimi i furnitorëve** – Cilat programe do të përmirësojnë furnitorët lokalë për të përmbushur standardet e shumëkombësheve? Furnizimi lokal aktualisht është i kufizuar. **Horizonti kohor** – Çfarë do të ndryshojë në mënyrë të prekshme për kompanitë brenda 12–24 muajve?

Pikat kryesore:

1. Strategjia deklaron qartë se nuk do të krijojë institucione të reja, por do të “ndërtojë një mekanizëm të integruar të qeverisjes” që lidh politikën, instrumentet dhe institucionet ekzistuese. Megjithatë, diagnoza e dokumentit identifikon problemin kryesor si fragmentimi institucional, me mandate të shpërndara dhe instrumente financiare të pa-koordinuara në të gjitha ministrinë. **Rreziku:** Nuk ka buxhet të dedikuar dhe as mekanizëm eskalimi. Strategjia do të kërkonte ose (a) një autoritet të vetëm të fuqizuar për politikën industriale me levë buxhetore, ose (b) një komitet ndërmintor të detyrueshëm, i kryesuar në nivel Kryeministri, me afate të zbatueshme, por asnjë nuk propozohet në këtë dokument.
2. **Barrë e Dyfishtë e Tranzicionit Gjellbër dhe Digjital është disproporcionale me kapacitetin e NVM-ve.** Objektivat 1.2 dhe 1.3 kërkojnë që NVM-të të dekarbonizojnë prodhimin, të adoptojnë praktika qarkore dhe të integrojnë teknologjitë e Industrisë 4.0 njëkohësisht. **Rreziku:** Prodhimi shqiptar dominohet nga ndërmarrje mikro dhe të vogla me marzhe të ulëta, të cilat nuk mund të përballojnë kostot e pajtueshmërisë, përmirësimet ISO/CE, retrofit-et e efikasitetit energjetik dhe transformimin digjital paralelisht brenda pesë viteve. Strategjia mungon në një qasje të shkallëzuar (p.sh. “rrugë tranzicioni sipas madhësisë së firmës”) dhe nuk ofron një garanci financimi tranzicioni të përshtatur për popullatën e NVM-ve.
3. **Arkitektura e Financimit është aspirative, jo operacionale.** Objektivat 4.1 dhe 4.2 premtojnë një “Kornizë të Integruar për Financimin Industrial dhe Mitigimin e Riskut” duke përdorur instrumentet e BE-së, IPA III, WBIF dhe Bankën e Zhvillimit të Shqipërisë (BASH). **Rreziku:** Kapitulli i financimit mbështetet pothuajse tërësisht në instrumente që janë ose (a) jo nën kontrollin e qeverisë shqiptare (alokimet IPA III, miratimet WBIF, ndërmjetësimi EIB), ose (b) të krijuara rishtazi dhe të pa-testuara (Banka e Zhvillimit sipas Ligjit 23/2025). Nuk ka garanci për thithje të brendshme, as angazhim minimal bashkë-financimi nga buxheti i shtetit i shprehur si përqindje fikse e PBB-së, dhe as kontigjencë nëse instrumentet e BE-së rialokohen për anëtarësimin e Ukrainës apo prioritete të tjera. Tabela e përmbledhjes financiare (Tabela 11) referohet por është bosh, pa vlera, gjë që përbën një boshllëk serioz për një plan pesëvjeçar.

Me respekt,

Marinela Jazaj

Drejtor, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri